

PKR.nr.475/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetar i trupit gjykues Naser Foniqi, me sekretaren juridike Sevdije Breznica, si procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit M.I, akuzuar për shkak të veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK dhe Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365, par. 3, lidhur me par.1, të KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.821/2014, të datës 12.09.2014, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 24.05.2018, në të cilin ish-in të pranishëm Prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari dhe i pandehuri M.I, të njëjtën ditë, me datë 23.11.2017, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M.I, i biri i A. dhe F, e vajzërisë H., i lindur me datë ..., në fshatin P. e E, Komuna P., tani me banim në fshatin Sh, Komuna P, me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar- prind i një fëmije të adoptuar, pensionist-realizon pension në shumë prej ..euro, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

I.

S e p s e: nga data e pa caktuar e deri me datë 13.08.2014, rreth orës 18:00, në fshatin Sh, Komuna P, në shtëpinë e tij, ka poseduar në kundërshtim me ligjin për armët, armën automatik i shkurtër “Intratec Tec” e kalibrit 9 mm dhe një karikator, ashtu që, me të njëjtën ka shtënë disa here në dasmën e djalit të tij, me ç rast policia ka vajtur në vendin e ngjarjes dhe të pandehurit ia ka sekuestruar armën si më lart, me një karikator dhe dy fishekë 9 mm,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK.

II.

S e p s e: me datë, kohë dhe vend të përshkruar si në dispozitivin e parë, në vendin ku kanë qenë të pranishëm një numër i madh i njerëzve, ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e tyre, në atë mënyrë që me rastin e martesës së djalit të tij, me armën automatik i shkurtër “Intratec Tec” e kalibrit 9 mm, ka shtënë disa herë,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365, par. 3, lidhur me par.1, të KPRK.
- Prandaj gjykata në bazë të neneve: 41; 45 dhe 73, të KPRK, si dhe nenit 365, të KPPK, të akuzuarit, i shqipton:

1. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj

- për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK, të përshkruar si në pikën 1, të dispozitivit të aktgjykimit dhe

2. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti,

- për veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365, par. 3, lidhur me par.1, të KPRK, të përshkruar si në pikën 2, të dispozitivit të aktgjykimit.
- **Me aplikimin e nenet: 80, par.1; 374 par.1, dhe 365, par. 3, lidhur me par.1, të KPRK, të akuzuarit M.I, gjykata i shqipton:**

DËNIM UNIK BURGIMI ME KUSHT

- **Në kohëzgjatje prej një (1) viti dhe katër (4) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (2) vite, në qoftë se i pandehuri **M.I**, gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër të re penale.
- I akuzuari lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, për shkak të gjendjes së tij ekonomike.
- Të akuzuarit i konfiskohet arma e llojit “Intratec Tec” e kalibrit 9 mm, një karikator dhe dy fishekë, e cila është përdorur për kryerjen e veprës penale.

A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.I.nr.807/2014, të datës 10.03.2016, ka akuzuar të pandehurit M.I, për shkak të veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK dhe Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365, par. 3, lidhur me par.1, të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 23.11.2017, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari M.I, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, si dhe ka shtuar se atëherë ka gjuajtur për gëzim, pasi ka martuar djalin e adoptuar nga vëllai i tij, se nuk ka fëmijë të tjerë, se gjendja e tij ekonomike është e rëndë, pasi jeton me bashkëshorten me nga 75 euro pension, e me të cilin, ka thënë se e kanë mjaft të vështirë ta sigurojnë ekzistencën elementare.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga i akuzuari, Prokurori i Shtetit ka thënë se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari M.I, për të dy veprat penale të përshkruara si në aktakuzë, se pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave të nenit 248 të KPPK, dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj, prokurori i ka propozuar gjykatës që ta pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit M, të merren si rrethana veçanërisht lehtësuese, pranimi i fajësisë dhe mosha e tij.

Pas deklarimit të të akuzuarit se ndihet fajtorë për kryerjen **e veprave penale për të cilat** është akuzuar nga Prokuroria, kryetari i trupit gjykues me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale **Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374, par. 1, të KPRK dhe Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365, par. 3, lidhur me par.1, të KPRK**, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata e shpalli fajtorë të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprë penale të kryer; pendimin e thellë të të akuzuarit pas kryerjes se veprës penale; intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur; sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe gjendjen e rëndë ekonomike të të akuzuarit dhe moshën e tij, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 4, të KPPK, pasi që pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit dhe personave që ai detyrohet t'i mbështes materialisht.

Vendimi që të pandehurit t'i konfiskohen arma, u mor në bazë të nenit 374, par. 5, të KPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 24.05.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.475/14, datë 24.05.2018.

Sekretare juridike,
Sevdije Breznica

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.